

PREZANTIM:

“PREFEKTI I QARKUT TIRANE”





QARKU I TIRANES

MESAZH I PREFEKTIT TE QARKUT TIRANE

PREFEKTI I QARKUT TIRANE


FUNKSIONIMI I PREFEKTIT TE QARKUT TIRANE

KONTAKT

1

QARKU I TIRANES

(Shpërndarja gjeografike e Qarkut të Tiranës, Përbërja e Qarkut të Tiranës,
Përmbledhja e Qarkut të Tiranës)




Qarku i Tiranës

Qarku i Tiranës është një nga 12 qarqet e Shqipërisë, duke përfshirë një territor prej 1,652 km². Qendra e Qarkut të Tiranës ndodhet në qytetin e Tiranës.



SHPERNDARJA GJEOGRAFIKE E QARKUT TE TIRANES






PERBERJA E QARKUT TE TIRANES

Bashkia Kamëz
Njësia Administrative Kamzë/Qytet
Njësia Administrative Paskuqan

Bashkia Vorë
Njësia Administrative Vorë/Qytet
Njësia Administrative Prezë
Njësia Administrative Bërxullë

Bashkia Kavajë
Njësia Administrative Kavajë/Qytet
Njësia Administrative Sydnej
Njësia Administrative Luz i Vogël
Njësia Administrative Golem
Njësia Administrative Helmas



Bashkia Tiranë
Njësia bashkiake nr.1,
Njësia bashkiake nr.2,
Njësia bashkiake nr.3,
Njësia bashkiake nr.4,
Njësia bashkiake nr.5,
Njësia bashkiake nr.6,
Njësia bashkiake nr.7,
Njësia bashkiake nr.8,
Njësia bashkiake nr.9,
Njësia bashkiake nr.10,
Njësia bashkiake nr.11
Njësia Administrative Petrelë
Njësia Administrative Farkë
Njësia Administrative Dajt
Njësia Administrative Zall Bastar
Njësia Administrative Zall Herr
Njësia Administrative Bërxhit
Njësia Administrative Krrabë
Njësia Administrative Baldushk
Njësia Administrative Shëngjergj
Njësia Administrative Vaqarr
Njësia Administrative Kashar
Njësia Administrative Pezë
Njësia Administrative Ndroq

Bashkia Rrogozhinë
Njësia Administrative Rrogozhinë/Qytet
Njësia Administrative Kryevidh
Njësia Administrative Sinaballaj
Njësia Administrative Lekaj
Njësia Administrative Gosë



PERMBLEDHJA E QARKUT TE TIRANES

RELIEVI

Relievi është i shumëllojshëm, si për sa i përket lartësive, ashtu edhe formave të tij., duke përfshirë kodra, fusha, male dhe një vijë bregdetare me shtrirje prej 33 km. Shtrihet nga niveli i detit deri në lartësinë 1828 m (maja e Malit me Gropa).

VENDNDODHJA

Qarku i Tiranës shtrihet në pjesën qendrore të Shqipërisë. Qarku i Tiranës kufizohet me Qarkun e Durrësit në Veri dhe Veri-Perëndim (rrethet Krujë dhe Durrës), me Qarkun e Dibrës në Veri dhe Veri-Lindje (rrethet Mat dhe Bulqizë), me Qarkun Elbasan në Lindje dhe Jug-Lindje, me Qarkun e Fierit në Jug dhe me detin Adriatik në Perëndim (rrethi i Kavajës).

POPULLSIA

Qarku i Tiranës është qarku me popullsinë më të madhe (1/3 e popullsisë) dhe me dendësinë e popullsisë më të madhe në krahasim me 12 qarqet e Shqipërisë. Popullsia e Qarkut të Tiranës ka patur një trend rritës gjatë viteve të fundit. Numri më i madh i banorëve të Qarkut të Tiranës është për grupmoshat aktive për punë (grupmosha 15-19 vjeç dhe grupmosha 20-24 vjeç).

BUJQESIA

Sipas publikimit të realizuar nga INSTAT (V.2016), Qarku i Tiranës disponon 57,000 ha tokë bujqësore dhe 109,000 ha pyje, livadhe, kullota dhe toka të tjera.

KLIMA

I ndodhur në zonën qendrore të Shqipërisë, Qarku i Tiranës ka një klimë tipike mesdhetare, me dimër të butë dhe verë të nxehtë. Temperaturat mesatare vjetore luhaten nga 5.8°C (Bixë), në 14.8°C (Kavajë) dhe 15.1°C (Tiranë).



PERMBLEDHJA E QARKUT TE TIRANES

PBB

Sipas publikimit të realizuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (V.2010), struktura e PBB-së e Qarkut të Tiranës është e ndarë sipas sektorëve: *shërbime & tregti* (46.4%); *bujqësi* (20.7%); *ndërtim* (14.3%); *industri* (9.7%).

ARSIMI / TREGU I PUNES

Qarku i Tiranës përbën qarkun më të arsimuar, pasi ka numrin më të lartë të institucioneve arsimorë si dhe numrin më të lartë të nxënësve dhe studentëve në Shqipëri. Gjithashtu Qarku i Tiranës përbën tregun më të madh të punës dhe ka nivelin më të ulët të papunësisë në Shqipëri.

TURIZMI

Turizmi malor gjen një terren për t'u zhvilluar në saj të Malit të Dajtit me Parkun Kombëtar, me një sipërfaqe prej 23.374 ha. Turizmi detar zhvillohet në zonat bregdetare të Golemit, Spillesë-Karpenit etj. Zhvillimi i turizmit të biznesit dhe konferencave është i lartë, për shkak të përqëndrimit të institucioneve qeveritare, joqeveritare, shoqatave ndërkombëtare etj, si dhe zinxhirëve të njohur hotelierë si: Sheraton, Plaza, Tirana international etj, të cilët ofrojnë mundësinë e zhvillimit të kongreseve, konferencave, seminareve dhe aktiviteteve të tjera, sipas standardeve ndërkombëtare.

KULTURA

Qarku i Tiranës është një muze i hapur i historisë së vjetër dhe të re të Shqipërisë. Ai mbart një histori të lashtë, e cila përbëhet kryesisht nga kultura ilire, nga kalatë e shumta që kanë vlera të mëdha historike. Qarku i Tiranës ka 183 monumente kulture të shpallura, prej të cilave, 168 ndodhen në rrethin e Tiranës dhe 15 në rrethin e Kavajës.

TRANSPORTI

Qarku i Tiranës konsiderohet një qark me ritme të larta sociale, ekonomike dhe shoqërore. Qarku i Tiranës lidhet me qarqet e tjerë, duke qënë nyja kryesore e transportit rrugor, hekurudhor dhe ajror.



GUIDA E QARKUT TE TIRANES



Qarku i Tiranës shtrihet në një zonë gjeografike interesante dhe me një natyrë ku lehtësisht identifikohen diversiteti dhe potencialet e shumta turistike. Gjendet në kryqëzimin e rrugëve të rëndësishme tokësore me rëndësi kombëtare dhe rajonale, me fushë të gjerë pjellore, të rrethuar me kodra dhe male të veshura me pyje, me pasuri të shumta hidrike, klimë të përshtatshme për zhvillimin bujqësor dhe urban, me dalje në det dhe burime të shumta turistike.



2

MESAZH I PREFEKTIT TE QARKUT TIRANE

(Mesazh hyrës nga Prefekti i Qarkut Tiranë)



I nderuar qytetar i Qarkut të Tiranës,

Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë përballet çdo ditë me sfida të reja, të cilat kapërcehen me pasionin e një administrate shtetërore, që ka një qëllim të qartë:

“Mundësimi i marrjes së një shërbimi cilësor për çdo qytetar të Qarkut të Tiranës”.

Asnjë shoqëri nuk mund të shkojë përpara pa pjesëmarrjen aktive të qytetarit në zhvillimet sociale, ekonomike dhe politike të Qarkut përkatës. Për këtë arsye, prioriteti i institucionit të Prefektit të Qarkut Tiranë është afrimi me qytetarët, përmes takimeve dhe krijimit të kanaleve të komunikimit (si website, email etj).

**Me respekt,
Admir ABRIJA
Prefekt i Qarkut Tiranë**

3

PREFEKTI I QARKUT TIRANE

(Historiku i Prefektit të Qarkut Tiranë, Misioni dhe vizioni i Prefektit të Qarkut Tiranë)



HISTORIKU I PREFEKTIT TE QARKUT TIRANE

V. 1912-1926

Nga viti 1912 deri më vitin 1926, Tirana ishte nënprefekturë nën juridiksionin e Prefekturës të Durrësit dhe vetëm pas shpalljes së Tiranës si kryeqytet i Shqipërisë, marrëdhënia me Ministrinë e Punëve të Brendshme filloi të ishte i drejtpërdrejtë.

V. 1926-1944

Në vitin 1926, Dhoma e Deputetëve dhe Senati miratoi organizimin e ri të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që e përfshiu për herë të parë Qarkun e Tiranës në Departamentin e Qendrës. Kjo formë e organizimit vazhdoi deri në vitin 1944 dhe titullari më i lartë i administratës në shtet ishte prefekti.

V. 1944-1947

Pas vitit 1944, edhe pse pa titullarët e tyre, prefekturat u ruajtën si njësi administrative deri më 1947.



HISTORIKU I PREFEKTIT TE QARKUT TIRANE

V. 1947-1992

Nocioni administrativ “Prefekturë” nuk u aplikua për rreth 45 vjet.

V. 1992-1993

Forma e organizimit me prefektura u rivendos përsëri në vitin 1992, me miratimin e ligjit “Për prefekturat”, më datë 22 shtator 1992. Më 26 korrik 1993, Këshilli i Ministrave nxori vendimin për ndarjen dhe krijimin e 12 prefekturave në vend.

V. 1993-1997

Më 22 prill 1997, ligji “Për prefekturat” pësoi ndryshime.



HISTORIKU I PREFEKTIT TE QARKUT TIRANE

V. 1997-2002

Përsëri ligji “Për Prefekturat” pësoi ndryshime më datë 25 korrik 2002.

V. 2002-2016

Përsëri ligji në lidhje me Prefekturat pësoi ndryshime më datë 27 tetor 2016

V. 2016-

Aktualisht, veprimtaria e Institucionit të Prefektit bazohet në Ligjin Nr. 107, më datë 27 tetor 2016 “Për prefektin e qarkut”.



MISSIONI DHE VIZIONI



Misioni - Misioni i Prefektit të Qarkut Tiranë është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave, në nivel qarku.

Vizioni - Vizioni i Prefektit të Qarkut Tiranë është vendosja e marrëdhënieve të forta bashkëpunuese ndërmjet Prefektit të Qarkut Tiranë me organet dhe institucionet e administratës shtetërore, me organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, me degët territoriale që veprojnë në qark dhe me institucionet e tjera shtetërore.

4

FUNKSIONIMI I PREFEKTIT TE QARKUT TIRANE

(Forma e funksionimit të Prefektit të Qarkut Tiranë)



Prefekti ka një sërë kompetencash si Përfaqësues i Këshillit të Ministrave për të bashkërenduar punën e njësive të pushtetit vendor me atë qëndror, si edhe bashkëveprimin institucional të drejtorive të dekoncentruara të Qarkut. Prefekti është në krye të çdo task – force që merret nga qeveria në nivel qarku, por ka dhe të drejtën të ngrejë grupe pune ose task – forca për problematikat e ndryshme që shfaqen në qark, në bashkëveprim me të gjitha institucionet vendore dhe drejtoritë rajonale.



Pranë Prefektit të Qarkut funksionon organi këshillues i tij. Në organin këshillues marrin pjesë kryetari i këshillit të qarkut, kryetarët e bashkive, drejtori i policisë vendore, drejtuesit e njësisë së Forcave të Armatosura për qarkun, drejtuesit e shërbimit shëndetësor, drejtuesit e drejtorisë arsimore rajonale, drejtuesit e drejtorive rajonale të tatimeve dhe doganave, drejtues të tjerë të degëve territoriale që veprojnë në qark, të caktuar nga prefekti, si dhe përfaqësues nga shoqëria civile.



PERGJEGJESITE E PREFEKTIT TE QARKUT TIRANE

- Verifikimi i ligshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

- Bashkërendimi i veprimtarisë ndërmjet degëve territoriale, që vepron në qark me organet e njësive të vetëqeverisjes vendore.

- Raportimi periodik në Këshillin e Ministrave për veprimtarinë e degëve territoriale që vepron në qark, sipas urdhrat të Kryeministrit, dhe për probleme të veçanta, sipas urdhrat të ministrit.

- Informimi çdo gjashtë muaj i institucioneve qendrore për veprimtarinë e strukturave të tyre të varësisë, në nivel qarku.

- Nxitja dhe zhvillimi i marrëdhënieve dhe i veprimtarive me institucionet homologe sipas marrëveshjeve përkatëse.

- Drejtimi i strukturave për parandalim, menaxhim, rehabilitim të pasojave në rastet e emergjencave civile.

- Drejtimi i task-forcave, krijimi i organizmave të përkohshëm, të komiteteve, të grupeve të punës dhe të komisioneve për çështje të caktuara.

- Drejtimi ose pjesëmarrja në ceremonitë zyrtare shtetërore që zhvillohen në nivel qarku, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Forcimi i kapaciteteve institucionale në zbatim të programeve të buxhetit të shtetit.

- Kontrolli dhe monitorimi i zbatimit, në nivel qarku, i politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në bujqësi, arsim, shëndetësi, mjedis, rend publik, shërbim zjarrfikës, ndihmë dhe përkrahje sociale, turizëm dhe kulturë.

- Bashkërendimi i veprimtarisë së tij me agjencitë dhe inspektoratet që vepron në nivel qarku, si dhe monitorimi i veprimtarisë së tyre. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin me drejtuesit e këtyre institucioneve, prefekti i drejtohet ministrit përgjegjës.

- Shqyrtimi çdo muaj i veprimtarisë së degëve territoriale që vepron në qark dhe bashkërendimi i punës ndërmjet tyre dhe organeve të vetëqeverisjes vendore, në zbatim të programit të Këshillit të Ministrave.

- Bashkërendimi i punës me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve dhe struktura të tjera zgjedhore vendore, në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor.

- Ushtrimi i përgjegjësisë dhe detyrave të tjera që i ngarkohen me akte ligjore ose nënligjore.

5

KONTAKT

(Format e kontaktimit të Prefektit të Qarkut Tiranë)



PREFEKTI I QARKUT TIRANE



KONTAKT:

Rruga e Kavajës, Tiranë

Email: prefekti@prefektitirane.gov.al

Web: www.prefektitirane.gov.al

Tel: +355 (04) 240867

Fax: +355 (04) 240866



KONKLUZIONE



1. Qarku i Tiranës është një nga 12 qarqet e Shqipërisë. Qendra e Qarkut të Tiranës ndodhet në qytetin e Tiranës.
2. Qarku i Tiranës konsiderohet një qark me ritme të larta sociale, ekonomike dhe shoqërore.
3. Prefekti i Qarkut Tiranë është organ përfaqësues i Këshillit të Ministrave në njësinë administrativo-territoriale të Qarkut të Tiranës.
4. Veprimtaria e Institucionit të Prefektit bazohet në Ligjin Nr. 107, më datë 27 tetor 2016 “Për prefektin e qarkut”.
5. Misioni i Prefektit të Qarkut Tiranë është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave, në nivel qarku.



REFERENCA

1. Ligji Nr 107/2016 ***“Për prefektin e qarkut”***
2. Web-i i Këshillit të Qarkut Tiranë: <http://www.qarkutirane.gov.al/>
3. Web-i i Prefektit të Qarkut Tiranë: <http://www.prefektitirane.gov.al/>





FALEMINDERIT!